

Shërbimet në fushën e funksioneve dhe kompetencave të deleguara

- Funksionet dhe kompetencat e deleguara janë të detyrueshme ose jo të detyrueshme.
- Funksione dhe kompetenca të detyrueshme janë ato të përcaktuara me ligj.
- Institucionet qendrore, kur lejohet me ligj, autorizojnë bashkinë të kryejnë funksione të caktuara, duke përcaktuar, kur është e nevojshme, procedurat e kryerjes e të kontrollit për zbatimin e tyre.
- Institucionet qendrore mund të autorizojnë bashkinë të ushtrojnë një kompetencë të vetme për një funksion të caktuar.
- Bashkisë mund t'i delegohen funksione dhe kompetenca të tjera jo të detyrueshme, mbi bazën e një marrëveshjeje midis njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse dhe institucionit qendror përgjegjës me ligj për këtë funksion ose kompetencë.
- Në çdo rast qeverisja qendrore u garanton njësisë të vetëqeverisjes vendore mbështetjen e nevojshme financiare për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave të deleguara.
- Bashkia me nismën e saj, mund të përdorë burimet e veta financiare për ushtrimin e funksioneve e të kompetencave të deleguara, me synim ngritjen në nivel më të lartë të shërbimit në interes të bashkësisë.